



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality Skenderaj

### Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 43, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 37 paragrafi 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt nr.01-110-385 të dt.03.12.2008, Rregulloren e punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrat nga procesverbali i mbledhjes së KOMITETI PËR POLITIK E FINANCAT, i mbajtur me datë 23.01.2025, në ora 10:00, në sallën e bordit të drejtoresh.

#### **Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:**

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Shqyrtimi i Raportit financiar përfundimtar të buxhetit komunal janar-dhjetor 2024, me Nr. 02-052/01-0002664/25, i datës 17.01.2025, (Raporton drejtori i DBF-së, z. **Ismet Aliu**);
5. Të ndryshme.

**Kryesuesja e kuvendit znj. Adelina Spahiu:** Të nderuar anëtar KPF-së, drejtor të drejtorive, në këtë mbledhje i kemi 6 anëtarë.

Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës, e hap debatin, nëse nuk ka, konstatojmë me (6) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Rendi i ditës.

-Vazhdojmë me miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar, e hap debatin, nëse nuk ka konstatojmë me (6) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Vazhdojmë me piken 4 të rendit ditës:

-Shqyrtimi i Raportit financiar përfundimtar të buxhetit komunal janar-dhjetor 2024, me Nr. 02-052/01-0002664/25, i datës 17.01.2025, (Raporton);

**Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu:** Fjala përshëndetëse, me kohe e keni pas Raportin financiar përfundimtar të buxhetit komunal janar-dhjetor 2024, sipas kërkesave ligjore është përgatite gjitha pikat në detaje janë të përfshira, gjitha lëvizjet buxhetore që kanë ndodhur gjatë vitit 2024, duke filluar nga buxheti fillestar që e kemi pas të aprovuara në kuvend komunal, 18,582.310.00€, ndërsa lëvizjet gjatë vitit 2024, shtesë edhe për 2,722.113.00€ kanë rrjedh nga granditë e përgjithshëm 1,186.644.00€, pastaj pjesa e bartjes të hyrave vetanake nga viti 2023 të pa shpenzuara 340 mijë€, dhe nga granditë e performances që e kemi përfitua 603,119.00€, për të pas një buxhet për shpenzim deri në fund të vitit 2024, në vlerë prej 21,304.423.13€. Të hyrat vetanake janë realizua në 93.55%, gjitha mjetet e pa shpenzuara nga tre mujori paraprak janë bartur në tre mujorin në vijim sipas procedurave ligjore. Me vendime gjyqësore përmbarimore të emër të shtesave shujtave licencimit dhe inflacionit janë shpenzuar 2,455.186.46€, të paguara nga kategoritë të ndryshme. Të hyrat vetanake janë realizuara në 93.55%, ose 1,762.696.00€, Buxheti i shpenzuar 20,952.941.40€, 55.93%, Paga dhe shtesa, 11.91% Mallra dhe shërbime, 1.45% Shërbime komunale, 5.24%, subvencione dhe 25.47% Investime kapitale. Në faqen 9 janë shpenzimet sipas kodeve dhe nenkodeve, në faqen 11 është lista e projekteve kapitale që janë shpenzuar 5,337.593.84€ ose 95.73%, sipas planit në realizimin e projekteve janë shpenzuar 4,575.785.13€, me vendime gjyqësore përmbarimore në kategorinë e projekteve kapitale janë marrë 761,808.71€ ose 13.44%.

Pjesa e fundit, është shpenzimi i buxhetit neper të gjitha kategoritë sipas të gjitha drejtorive, dhe i kemi obligime të pa paguara për vitin 2024, në total 332.893.93€, në Mallra dhe shërbime janë 124,562.97€, Shërbime komunali 10,984.00€, Subvencione transfere 48,600.00€, dhe Investime kapitale 148,746.93€. Të hyrat komunale që priten për bartje mbesin të pa shpenzuara vitin 2024 do të jenë rreth 235,100.00€ së bashku me gjobat e gjykatave të cilat deri në momentin e hartimit të këtij raporti nuk kemi pas evidencë të saktë. Ndërsa të pa shpenzuara nga grandit qeveritar kanë mbetur 84,053.00€ në projektet kapitale, kjo ishte në pika të shkurta sa i përket këtij raporti.

**Kryesuesja:** E hap debatin, fjalën ja kaloj;

**Illir Ejupi-IDEAL:** Fjala përshëndetëse, i kam disa pyetje për shpenzime, të shpenzimi; Të shtesat e veçanta për tu zgjedhur, a kanë me na tregua për kanë është fjala? Të Shtesa tranzitore dhe të shpenzimi Kujdestaria puna gjatë natës, puna jashtë orarit të punës, a mundesh me na tregua për cilët kategori janë nda këto shtesa?

**Kryesuesja:** Dikush tjetër, nëse nuk ka, fjalën ja kaloj;

**Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu:** Të shpenzimet te shtesat e veçanta për tu zgjedhur, ka të bëjë me kategorinë e pagave të mëditjeve të anëtareve të KPF-së, dhe asamblistëve, shpenzimit tjetër ka të bëjë me personelin shëndetësor. Ndërsa shpenzimet, shtesat tranzitore janë ato shpenzime që i ka prek ligji i pagave dhe në afate 2 vjeçar i marrin ato shtesa tranzitore me tepër, dhe ky shpenzim nuk do të jetë në vitin 2025.

**Kryesuesja:** Dikush tjetër, nëse nuk ka, shkojmë në votim, konstatojmë me (4) vota për, (0) kundër dhe (2) abstenim rekomandohet për kuvend për përkrahje. Shqyrtimi i Raportit financiar përfundimtar të buxhetit komunal janar-dhjetor 2024, Nr.02-052/01-0002664/25, i dt. 17.01.2025.

-Vazhdojmë me piken 5 të rendit ditës;

-Të ndryshëm; e hap debatin nëse nuk ka, me kaq e mbyllim këtë mbledhje shihmi në seancë e kuvendit, për datë 30.01.2025, në ora 10:00, gjitha të mirat.

Procesmbajtësi



Kryesuesja e Kuvendit